



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimni/Prodato Received/Delivery	08-04-2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICE	2006/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.218/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.218/2022 të datës 10.03.2022 të parashtruar nga ankuesi _____, me adrese rruga _____

kundër Vendimit KA.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.218/2022 e datës 10.03.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.04/2022 i datës 14.02.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 10.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1281/2022 të regjistruar me numër A.nr.218/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

15.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 28.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1281/2022 të regjistruar me numër A.nr.218/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e datës 12.01.2022 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Emailin e datës 20.12.2021 nga _____ për ankuesin; Kërkesën e datës 22.01.2021 nga ankuesi për Departamentin e Personelit në SKGJK; Akt Emërimit e datës 25.08.2017 për ankuesin; Diplomën në emër të ankuesit; Kërkesë për Qasje të Përdoruesve në SIMFK e datës 25.02.2016; Autorizimin për qasje në SIMFK V7 (Freebalance) e datës 25.02.2016; Emërimi dhe fletë deponimi i nënshkrimeve e datës 23.08.2016; Certifikatën në emër të ankuesit e datës 27.01.2016, 18.12.2015; Vendimin e datës 28.10.2015 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.03.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 28.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 25.08.2017 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Depoist*, në Gjykatën Themelore në Prizren. I njëjti më datë 22.01.2021 i është drejtuar me shkresë Departamentit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK), me kërkesë për ngritje të koeficientit. Ankuesi me datë 12.01.2022 është njoftuar nga organi i punësimit se kompensimi i pagës bëhet mbi bazën e akt emërimit dhe se ngritja e koeficientit bëhet në bazë të procedurave të avancimit.

Kundër njoftimit të datës 12.01.2022 të SKGJK-së, ankuesi më datë 12.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK, më datë 14.02.2022 ka nxjerr Vendim KA.nr.04/2022 më të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kundër Vendimit KA.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Rrjedhimisht ankuesi në ankesën e tij pretendon se i takon e drejta e ngritjes se një (1) koeficienti të pagës dhe kompensimi i diferencës së koeficientit në mënyrë retroaktive nga data 25.02.2016, sepse sipas të njëjtit nga data 28.10.2015 me Vendim Nr.01/640 të Komisionit të Këshillit Gjyqësor është sistemuar në pozitën e *Ndihmës Zyrtar i Logjistikes* në Gjykatën Themelore në Prizren dhe njëherit ka ushtruar edhe pozitën e zyrtarit

zotues që nga data 07.04.2016. Andaj, ankuesi pretendon ngritjen e një (1) koeficienti të pagës pasi që sipas tij në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës zyrtaret zotues e kanë koeficientin e pagës shtatë (7), dhe kërkon kompensimin retroaktiv nga data 25.02.2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër I.Gj.nr.1/20187-165 të datës 25.08.2017 është i punësuar në pozitën e punës *Depoist 3*, me koeficient të pagës gjashtë (6) në Gjykatën Themelore në Prizren. Akt Emërimi është nënshkruar nga ankuesi me datë 28.08.2017 dhe i njëjti është pajtuar me kushtet e punës në pozitën përkatëse në Shërbimin Civil.

Kolegji në shkresa të lëndës ka gjetur autorizimin për qasje në SIMFK (Freebalance) të datës 25.02.2016, dhe formularët e emërimit dhe fletë deponimit të nënshkrimeve, ku shihet se ankuesit i është dhënë autorizim për qasje në freebalance, mirëpo nuk ka gjetur ndonjë dëshmi se është zhvilluar procedurë e avancimit dhe rrjedhimisht ndonjë akt administrativ të organit të punësimit apo shkresë të emërimit i cili është nënshkruar pas datës 28.08.2017 dhe përmes të cilës ankuesit do t'i njihej titulli i ri i punës dhe rrjedhimisht e drejta e realizimit të koeficientit të pagës me koeficient shtatë (7).

Me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 9 paragrafin 1 përcaktohet se: *1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*, andaj duke ju referuar kësaj dispozite ligjore Kolegji ka gjetur se ankuesi realizon pagën me koeficient gjashtë (6) ashtu siç është përcaktuar në Aktin e Emërimit me numër I.Gj.nr.1/20187-165 të datës 25.08.2017.

Rrjedhimisht Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrës së Vendimit KA.nr.04/2022 të datës 14.02.2022 më të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar ka zbatuar drejtë ligjin material sepse me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 27 përcaktohet se: *1. Avancimi nga një pozitë më e ultë në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ultë në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të:(1.4) kalimit me sukses të testimit, dëshimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale*, për çka në rastin konkret nuk ka dëshmi se është zhvilluar procedurë për avancim në karrierë dhe si rrjedhojë as akt administrativ apo shkresë të emërimit me të cilin ankuesit i është njohur titulli i ri i punës dhe koeficienti i pagës shtatë (7), kështu që Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit për ngritjen e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë (7) dhe kompensimi retroaktiv i diferencës së një koeficientit nga data 25.02.2016 është i pa bazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.218/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

